

RAPORTIMI VJETOR, MBAJTUR PËRPARA KOMISIONIT PARLAMENTAR TË EKONOMISË

PËRMBLEDHJE

PJESA I: Vështrim i shkurtër mbi tregjet e mbikëqyrura – 2008

PJESA II: Analizë e veprimtarisë së AMF

Rregullimi

Mbikëqyrja

Masat

Kriza

PJESA III: Bashkëpunimi

PJESA IV: Kapacitetet institucionale

PERSPEKTIVA

PËRMBLEDHJE E VEPRIMTARISË SË AMF-SË - 2008

Të nderuar deputetë,

Kam nderin, detyrimin dhe kënaqësinë, të raportoju sot para jush mbi punën, arritjet dhe sfidat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare gjatë vitit të kaluar.

Në vitin 2008, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare rriti dhe konsolidoi pozicionin e tij në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare jo bankare, ku përfshihen sigurimet, letrat me vlerë dhe pensionet private suplementare. Veprimtaria e AMF-së vijoi të mbështesë misionin themelor të **mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe publikut në tërësi**, të lidhur ngushtë me **stabilitetin financiar të operatorëve të mbikëqyrur**.

Përpara se të kaloj në detaje të punës konkrete, realizimeve dhe sfidave që shtroi viti i kaluar për drejtuesit dhe ekipin e AMF-së, gjej me vend të bëj një **paraqitje të shkurtër të tregjeve të mbikëqyrura me karakteristikat kryesore, tendencat e potencialet e tyre**.

(i) Sektori i sigurimeve vijoi të mbajë peshën kryesore në tregun financiar jo bankar në Shqipëri dhe për këtë arsye pati vëmendjen e veçantë dhe fokusimin e pjesës më të madhe të burimeve dhe kapaciteteve të AMF-së.

Raporti i depozituar në Kuvend, në muajnt Shkurt 2009, është bazuar në masë të madhe në të dhënat e tregut për 9 mujorin e vitit 2008, ndërsa kjo përmbledhje bën përditësimin e situatës me shifrat e fundvitit, pas përpunimit të të dhënave përkatëse operative të raportuara nga shoqëritë.

Si fillim, dëshiroj të përmend përpara jush shifra dhe fakte pozitive, që tregojnë për stabilitet të tregut dhe rritje graduale me një strukturë gjithnjë e më të diversifikuar dhe balancuar.

- Penetrimi i sigurimeve i shprehur në përqindje të PBB-së, gjatë 2008, ishte 0.68%, krahasuar me 0.61% në vitin 2007. Tregu i sigurimeve në vetvete pati rritje të kënaqshme, por na duhet të theksojmë se do të duhet kohë që ky raport të tentojë drejt shifrave të vendeve të zhvilluara.
- Në tregun e sigurimeve vijuan të operojnë 10 shoqëri të sigurimit, 6 shoqëri kanë pronësi vendase, ndërsa 4 të tjerat kanë njëkohësisht pronësi vendase dhe pjesëmarrje influencuese të huaj.
- Gjatë vitit 2008, numri i kontratave të sigurimit u rrit me 27%. Të ardhurat nga primet e sigurimeve arritën në rreth 7 miliardë lekë, ose 19% më shumë se në vitin e kaluar, çfarë është më e lartë se mesatarja e vendeve në zhvillim (11.8%). Kjo rritje është reale dhe i

dedikohet rritjes së numrit të klientëve dhe tregut në tërësi, ndërsa tarifat e sigurimeve të detyrueshme nuk patën asnjë rritje, madje në sigurimin kufitar pati ulje në krahasim me vitin 2007. Shoqëritë e sigurimit ruajtën ose rritën nivelin e të ardhurave, duke qenë në harmoni dhe duke përcaktuar tendencën e tregut.

- Pavaresisht se Sigurimet e detyrueshme motorrike vazhdojnë te dominojnë tregun me 56% të të ardhurave, vlen të përmendim që struktura e produkteve u përmirësua ndjeshëm në favor të sigurimeve vullnetare, që arritën të kenë 44% të totalit të primeve, kundrejt 35% që kishin në vitin 2007. Sigurimet vullnetare u rritën me rreth 50% në krahasim me vitin 2007.
- Vend të veçantë në sigurimet vullnetare gjatë vitit 2008 zunë sigurimet inxhinierike dhe të përgjegjësisë, të lidhura me punime të ndërtimit, apo vepra të infrastrukturës.
- Sigurimet e jetës dhe shëndetit patën tendencë rritje më të lartë se sigurimet e jo - jetës, por mbetën sërish në minorancë me rreth 7% dhe të varura në masë të madhe nga niveli i kredidhënies nga bankat.
- Viti 2008 shënoi rritjen e pranisë së grupeve të huaja në Shqipëri, nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes në investimet ekzistuese.

Në vitin 2008 kemi patur hapa pozitivë konkretë, me produkte të reja të jetës dhe shëndetit, kryesisht nga shoqëritë me kapital të huaj.

Megjithë progresin e shfaqur nga tregu në 2008 dhe arritjet e përmendura më sipër, niveli i kulturës i penetrimit së sigurimeve dhe besimi tek operatorët mbeten ende sfida të këtij sektori në Shqipëri, ndërsa shkalla e dëmshpërblimeve qëndron në nivele për tu përmirësuar. Edhe në vitin 2008, ashtu si në vitet paraardhës, ne përcollëm një raport të ulët dëme prime për shoqëritë e sigurimit dhe tregun në tërësi (28% - shifër e 9 mujorit), çfarë tregon që mbetet ende shumë për tu bërë nga shoqërië e sigurimit në përmbushje të plotë të detyrimit të marrë përsipër. Pagesat e dëmeve janë mjeti më i mirë i marketingut për rritjen e biznesit nga shoqëritë e sigurimit dhe nxitjen e vetëdijes dhe kulturës së sigurimeve në tërësi.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm që mjeti kryesor në përballimin e kësaj sfide, mbetet rritja e cilësisë së shërbimit nga shoqëritë e sigurimit kundrejt klientëve dhe publikut në tërësi.

(ii) **Tregu i letrave me vlerë në fokusin e AMF-së, në vitin 2008, vazhdon të përbëhet nga tregu me pakicë i instrumenteve të borxhit të Qeverisë.** Numri i operatorëve të këtij tregu ishte 18, nga 17 në vitin 2007, ndërsa niveli i transaksioneve mbetet pothuajse i njejte me atë të vitit 2007.

Platforma elektronike GSRM, i ka shërbyer publikut dhe ka rritur transparencën për kuotimet dhe transaksionet në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë. Konkretisht, ajo përditëson në kohë reale informacionin mbi nivelin e kërkesë ofertës dhe transaksionet në tregun me pakicë të instrumenteve të borxhit të Qeverisë, çfarë e ka shndërruar atë në një nga rubrikat më të klikuara në faqen web të AMF-së.

Ka patur vend për plotësim të kuadrit ligjor të tregut të letrave me vlerë dhe zhvillimet në këtë drejtim do të përmenden më poshtë.

(iii) **Tregu i pensioneve private** është në fillimet e tij në Shqipëri. Gjatë vitit 2008 në këtë treg vijuan të ushtrojnë veprimtarinë tre operatorë. Megjithë rritjen e numrit të kontribuesve me 34% dhe vëllimit të kontributeve me 65% kundrejt vitit të kaluar, ky treg mbeti shumë i vogël me rreth 53 milionë lekë. Kuadri ligjor ka patur mangësi thelbësore lidhur me organizimin e sistemit privat të pensioneve, përfshirë këtu çështjen e kritereve dhe formave të investimeve afatgjatë që duhet të garantojnë kthimin e përfitimeve tek kontribuesit. Për të çbllokuar situatën dhe për t'i dhënë frymëmarrje këtij tregu, gjatë vitit 2008 është punuar intensivisht për hartimin e një projektligji të ri sipas standardeve dhe përvojave më të mira.

Të nderuar deputetë,

Pas vështrimit të shkurtër mbi gjendjen e tregjeve financiare jo bankare në Shqipëri, dëshëroj t'ju paraqes një analizë të përmbledhur të veprimtarisë së AMF-së në përmbushje të funksioneve të saj rregullative dhe mbikëqyrëse.

Me kënaqësi ju raportoj se në vijim të punës së nisur që në fillimet e institucionit, gjatë vitit 2008 AMF ka bërë një punë të madhe në drejtim **të hartimit të katër projekt-ligjeve bazë dhe shumë akteve nënligjore që rregullojnë sektorin financiar jo bankar**. Procesi i përmirësimit dhe plotësimit të legjislacionit është mbështetur në standardet më të mira ndërkombëtare, dhe Direktivat Europiane dhe ka pasqyruar përvoja të suksesshme të vendeve të rajonit dhe më gjerë.

Më konkretisht, po bëj bëj këtu një përmbledhje të shkurtër mbi 4 projekt – ligjet e rëndësishme të hartuara gjatë vitit 2008

Projekt Ligji “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” erdhi si nevojë e rishikimit të ligjit të mëparshëm të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së mbajtësve të mjeteve motorrike ndaj palëve të treta, në funksion të zhvillimeve në vend dhe përfshirjes së standardeve dhe praktikave më të mira. Objekti i tij është zgjeruar me përfshirjen e sigurimeve të detyrueshme të përgjegjësisë në sektorët e aviacionit dhe marinës dhe sigurimin e detyrueshëm

të pasagjerëve në mjetet publike. Në këtë projekt ligj janë përfshirë kërkesat e direktivave motorrike Europiane, ku vlen të përmend qendrën e informacionit të sigurimeve të detyrueshme, ekzistenca dhe funksionimi i së cilës pritet të ndikojë në uljen e ndjeshme të numrit të mjeteve të pasiguruara. Përfshirja dhe përditësimi i informacionit të dëmeve në këtë qendër do të mundësojë monitorimin më të mirë të procesit të dëmshpërblimeve dhe krijimin e sistemeve moderne të tarifimit në funksion të një tregu të liberalizuar me standarde të larta.

Gjej rastin të nderuar deputetë, të përshendes kontributin tuaj dhe t'ju falënderoj për të gjithë angazhimin që keni treguar në shqyrtimin dhe miratimin në Shkurt 2009 të këtij ligji shumë të rëndësishëm në funksionimin e tregut të sigurimeve që ze rreth 56%.

Tre projekt ligjet e tjera synojnë rregullimin e tregjeve të pensioneve private dhe letrave me vlerë dhe hartimi i tyre i njëkohshëm ka marrë në konsideratë lidhjet harmonike dhe kompleksitetin e këtyre sektorëve. Projektligji “Për fondet e pensioneve vullnetare” dhe Projektligji “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive“ synojnë të rregullojnë investimet afatgjata kolektive të popullatës dhe kanalizimin e tyre në investime eficiente me efekte të pritshme pozitive në kuadrin makroekonomik.

Projektligji “Për fondet e pensioneve vullnetare” është vënë në dispozicion të institucioneve dhe palëve të interesuara në fillim të vitit 2009. Ai rregullon një skemë komplementare të sigurime shoqërore duke përmirësuar sistemin ekzistues të pensionit vullnetar me synimin parësor nxitjen e shtetasve shqiptarë për të kontribuar dhe përfituar për herë të parë lehtësira tatimore. Projektligji në tërësi dhe në detaj siguron një mbrojtje të qenësishme të anëtarëve pjesëmarrës në fondet e pensioneve.

Projektligji “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive“ është hartuar duke marrë parasysh kërkesën në rritje të tregut për investime afatgjata dhe diversifikim të këtyre investimeve. Ai gjithashtu mbush një vakum ligjor, duke përcaktuar dhe qartësuar se kush është i lejuar t'i ofrojë publikut investues shërbime profesionale të investimeve të portofolit. Ky projektligj zëvendëson ligjin nr. 7979, datë 26 Korrik 1995 “Për Fondet e Investimeve”.

Projektligji “Mbi obligacionet e shoqërive aksionere dhe qeverisë vendore”, duke rregulluar në detaj emetimin publik të instrumentave të borxhit u jep më tepër hapësirë investitorëve si dhe subjekteve private apo vendore, për emetimin dhe investimin në këto instrumente. Ky projektligj u hartua edhe në kuadër të ndryshimeve që pësoi legjislacioni shqiptar në lidhje me legjislacionin publik financiar dhe tregtar, veçanërisht në lidhje me ligjet e reja të aprovuara: Ligji “Për Titujt”, Ligji “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” dhe Ligji “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”.

Gjatë hartimit të projektligjeve një vëmendje e vecantë i është kushtuar përafrit me direktivat/rregulloret e BE, si dhe standardeve të IOPS dhe IOSCO. Hartimi i këtyre projektligjeve është bërë nga AMF-ja në bashkëpunim me ekspertë të Bankës Botërore, Bankës Evropiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH), organizatën FSVC të USAID, si dhe assistencë ligjore vendase.

Të nderuar deputetë,

Për rëndësinë jetike që kanë të tre projekt ligjet e mësipërme në zhvillimin e sektorit financiar, unë do të kërkoja vëmendjen dhe angazhimin tuaj maksimal në shqyrtimin dhe miratimin tyre.

Krahas punës së madhe të përmendur më sipër për hartimin e katër projekt ligjeve bazë, gjatë vitit 2008 AMF ka punuar edhe për rishikimin dhe plotësimin e akteve nënligjore në të tre sektorët. Gjatë vitit 2008, Bordi i AMF-së miratoi 7 rregullore dhe 2 udhëzime, nga të cilat mund të përmend: rregulloren mbi vlerësuesit e dëmeve në sigurime, udhëzimin mbi përmbajtjen e raportit të auditimit për shoqëritë e sigurimit dhe rregulloren mbi procedurat e trajtimit të ankesave.

Procesi i licensimit është kryer në kursin normal të procedurave dhe afateve të përcaktuara dhe ka përfshirë licensimin e 32 vlerësuesve të parë të dëmeve në sigurime dhe licenca të reja të agjentëve për shoqëritë të ndryshme. Për herë të parë kemi në Shqipëri licensimin e një shoqërie të brokerimit në sigurime, si filial i një brokeri të njohur ndërkombëtar në sigurime dhe risigurime. Gjatë vitit 2008 AMF ka miratuar rritjen e pjesëmarrjes influencuese të investitorëve Uniqa dhe TBIH përkatësisht në shoqëritë e sigurimit Sigal (45.62%) dhe Sigma (87%+1) dhe investimin e shoqërisë Albsig në Maqedoni.

Të nderuar deputetë,

Monitorimi dhe mbikëqyrja e tregjeve financiare jo bankare në Shqipëri është funksion themelor i AMF-së. Për këtë arsye, vëmendje e vecantë dhe burime të konsiderueshme i janë kushtuar sjelljes së tregjeve, gjendjes financiare të operatorëve, tendencave dhe problematikave të zhvillimit të tyre.

Puna e monitorimit dhe mbikëqyrjes së tregjeve financiare jobankare ka konsistuar në një kombinim harmonik të inspektimeve në vend me analizat e plota të gjendjes financiare e treguesve të operatorëve, si edhe monitorimin e përputhjes së veprimtarisë me kuadrin ligjor në fuqi.

Duke qenë se **sigurimet e detyrueshme** mbajten peshën kryesore në tregun e sigurimeve (56%), AMF vijoi t'i kushtojë vëmendje të vecantë mbikëqyrjes së tij. Përvec inspektimeve në pikat e

shitjes, apo kontrollet mbi dëmet, vëmendje e vecantë iu kushtua përmirësimit të infrastrukturës së këtij tregu dhe njëkohësisht lehtësimit të monitorimit të tij. Rregjistri Elektronik i Sigurimeve të Detyrueshme, i administruar nga AMF ka funksionuar më së miri dhe ka mundësuar kryqëzimin e të dhënave të raportuara me ato të autoriteteve përkatëse të transportit. Shoqëritë janë informuar përkatësisht për shmangiet e pikave të tyre të shitjes dhe për korrektimin e problemeve janë marrë masat përkatëse nga AMF. Efektiviteti i platformës dhe mbikëqyrjes do të rritet me hedhjen në sistem dhe përditësimin e gjendjes së të gjithë dëmeve të sigurimeve të detyrueshme.

Janë realizuar teknikisht zgjidhje alternative për evidentimin e mjeteve motorrike të pasiguruara, ose me polica sigurimi jokorrekte. Hyrja në fuqi e ligjit të ri të sigurimeve në sektorin e transportit do të mundësojë funksionimin real të këtyre zgjidhjeve, që do të realizohen në bashkëpunim me strukturat përkatëse shtetërore.

Gjatë vitit 2008, AMF ka kryer 30 inspektime në vend në të tre sektorët. Koha dhe tematika e inspektimeve ka konsideruar specifikat e operatorëve të vecantë dhe problematikat e evidentuara nga analizimi i të dhënave të raportuara.

Gjatë vitit 2008 janë kryer inspektime në vend mbi gjendjen financiare të shoqërive të sigurimit dhe pensioneve, me synim verifikimin e gjendjes së aktiveve dhe investimit të tyre, përmbushjes së kriterëve ligjore për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike, rreziqeve të mëdha të siguruara dhe zbatimit të politikës së risigurimeve, likuiditetit të shoqërive dhe aftësisë për të shlyer në kohë detyrimet. Takimet me drejtuesit dhe stafet teknike dhe njësitë e auditimit të shoqërive kanë qenë pjesë e rëndësishme e procesit dhe kanë ndihmuar efektivitetin e inspektimeve.

Në fokusin e inspektimeve tek shoqëritë e sigurimit ka qenë edhe problemi kyc i trajtimit, vlerësimit dhe pagesës së dëmeve ndaj klientëve dhe të tretëve. Inspektimet kanë verifikuar zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, përfshirë këtu edhe udhëzimin e Ministrit të Financave për vlerësimin e dëmeve në sigurimet e detyrueshme motorrike. Inspektime tematike janë kryer edhe mbi veprimtarinë e agjentëve në sigurime dhe degëve të shoqërive të sigurimit. Vizitat në vend në institutet e pensioneve kanë trajtuar gjendjen dhe ecurinë kontributeve dhe aktiveve, ndërsa tek operatorët e tregtimit të letrave me vlerë është verifikuar respektimi i kuadrit ligjor në fuqi në kryerjen e transaksioneve.

Analizimi i gjendjes financiare dhe treguesve të operatorëve financiarë ka përfshirë elementë të rinj të modelit bashkëkohor të mbikëqyrjen me bazë rrezikun. Vizioni i ri i AMF-së përfshin monitorimin e tendencave dhe rrjedhimeve që mund të kenë ato më pas, krahas zbatimit të ligjit dhe respektimit të rregullave. Gjatë vitit 2008 numërohen 50 analiza financiare

të kryera nga AMF, ku përfshihen analizat paraprake, analizat 3 mujore dhe analizat e plota vjetore për të gjithë shoqëritë e sigurimit dhe institutet e pensioneve. Me kënaqësi ju informoj që shoqëritë e sigurimit arritën të përmbushin kriterin ligjor të fondit të garancisë në nivelin European (370 milionë lekë) të parashikuar për t'u plotësuar në Mars 2008, pavarësisht kohës së shkurtër që kishin në dispozicion. Gjatë vitit 2008, procesi i analizave financiare u pasurua me elementë të rinj të testimeve dhe paralajmërimeve të hershme. Përfshirja e këtyre elementëve synon parandalimin e problemeve, në vend të praktikës tradicionale të zgjidhjes së tyre pasi të kenë ndodhur. Vlen të theksoj se kalimi tek mbikëqyrja e bazuar në rrezik është një proces gradual që kërkon njëkohësisht përmirësimin e elementëve të manaxhimit të shoqërive, rritjen e rolit të profesioneve si aktuarët, auditorët, kontabilistët dhe rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse në AMF.

Cështjet dhe problemet e evidentuara në të gjitha proceset e mbikëqyrjes i janë adresuar përkatësisht Bordit të AMF-së që më pas ka dalë me **vendimet dhe masat përkatëse për parandalimin, apo korrektimin e shkeljeve të raportuara**. Është e qartë që një treg financiar i qëndrueshëm, transparent dhe efektiv arrihet nëpërmjet forcimit të regjimit të mbikëqyrjes. Forcimi i këtij pozicioni ka qenë prioritet i AMF-së kundrejt parandalimit, shmangies apo korrektimit në kohën e duhur të mangësive apo shkeljeve nga subjektet e mbikëqyrura.

Autoriteti ka punuar me kujdes për njohjen dhe identifikimin e risqeve dhe ka vepruar me mënyrat alternative ligjore sipas rasteve konkrete. Masat apo sanksionet e vendosura nga AMF në mënyrë transparente, të paanshme dhe profesionale kanë dhënë efekte pozitive në veprimtarinë e mëtejshme të operatorëve.

Gjatë vitit 2008, Bordi i Autoritetit ka vendosur 29 sanksione ndaj operatorëve, ku përfshihen: masa korigjuese për shoqëritë, masa korigjuese ndaj personave përgjegjës, gjopa ndaj subjekteve dhe personave përgjegjës, plan masash financiare në përmbushje të rregullave të manaxhimit të rrezikut dhe refuzim licence.

Në pozicionin e rregullatorit financiar, AMF ka vënë në fokus të vecantë krizën e tregjeve globale financiare. Në këtë këndvështrim, në fund të vitit 2008, AMF përpiloi matricën e risqeve potenciale me të cilat mund të përballen tregjet financiare jobankare në Shqipëri, duke përcaktuar për secilin risk mënyrën e monitorimit dhe shkallën e ndërhyrjes nga rregullatori. Shoqërive u është kërkuar vëmendje e vecantë në trajtimin e cështjeve që kanë të bëjnë me risigurimet, aktivet dhe diversifikimin e investimeve, ndërsa AMF monitoron më me intesitet në vazhdimësi të gjithë elementët e matricës. Pa dyshim, kriza financiare globale ka rritur nevojën e bashkëpunimit institucional me institucionet financiare brenda dhe jashtë vendit, si FMA e Austrisë etj.

Bashkëpunimi i AMF-së me institucione brenda vendit i ka shërbyer njëkohësisht efektivitetit në rregullimin e mbikëqyrjen e tregut dhe krijimit të hapësirave të zhvillimit të produkteve financiare, ndërsa komunikimi me tregjet dhe konsumatorin ka shënuar rritje.

- Bashkëpunimi me Ministrinë e Financave ka synuar përmirësimin e kuadrit ligjor për të tre sektorët e mbikëqyrur nga AMF. Në vitin 2008, ai është konkretizuar me Ligjin e ri ‘Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit’ dhe akte nënligjore të rëndësishme për sektorin e sigurimeve.
- Shkëmbimi i informacionit me Bankën e Shqipërisë ka rezultuar i efektshëm në evidentimin e nivelit të riskut të mbartur dhe transferuar brenda fushave të ndryshme të sektorit financiar. Shkëmbimi i informacionit, përvojës dhe zbatimi i procedurave të ngjashme nga të dy rregullatorët, ka lehtësuar procesin e rregullimit dhe mbikëqyrjes së sektorit financiar në tërësi.
- AMF është anëtare e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, në të cilën gjithashtu përfaqësohen Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë. Takimi i fundit i GKSF-së i është kushtuar tërësisht zhvillimeve dhe krizës në tregjet financiare ndërkombëtare dhe masave që duhen ndërmarrë për të shmangur apo zvogëluar efekte të mundshme në Shqipëri. Forcimi i regjimit të rregullimit dhe mbikëqyrjes dhe rritja e rolit të autoriteteve financiare, përbën një faktor kyç në minimizimin e problemeve të mundshme.
- Në kuadër të Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin për përafrimin e legjislacionit, AMF ka mbajtur një bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Integrimit. Të gjitha ndryshimet ligjore në sektorin financiar jobankar, të propozuara, apo miratuara gjatë vitit 2008 kanë pasqyruar kërkesat e direktivave Europiane.
- Bashkëpunimi i AMF-së me Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës i nisur në vitin 2007, u konkretizua 2008 me dy vendime të Këshillit të Ministrave që parashikojnë përkatësisht: (i) sigurimin e përgjegjësisë ligjore të tregtuesve të karburanteve dhe (ii) sigurimin e jetës dhe shëndetit të minatorëve nga aksidentet në punë. Rezultate të ngjashme për sigurimet në sektorin e ndërtimit do të jenë së shpejti rezultat i bashkëpunimit me Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
- Gjatë vitit 2008, AMF rriti komunikimin dhe bashkëpunimin me tregjet e mbikëqyrura. Tregjet dhe shoqatat profesionale kanë qenë pjesë integrale në realizimin e nismave dhe projekteve të ndërmara dhe të realizuara, ku mund të përmendim projekt ligjet dhe aktet nënligjore, apo nxitjen e produkteve të sigurimit në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë.

- Komunikimi me operatorët ka qenë në të gjitha nivelet, ndërsa takimet me bordet mbikëqyrëse të shoqërive janë shndërruar në një praktikë shumë të mirë të ndërveprimit dhe bashkëpunimit.

Të nderuar deputetë,

Dëshëroj të ndalem në mënyrë të vecantë në **raportet dhe komunikimin e pandërprerë që AMF mban drejtpërdrejt me konsumatorin dhe publikun në tërësi**, që kanë synuar mbrojtjen e interesave të të siguruarve, kontribuesve dhe të tretëve.

Në këtë funksion, njësia e mbrojtjes së konsumatorëve e ngritur pranë AMF-së ka trajtuar gjatë vitit të kaluar 68 ankesa të ardhura drejtpërdrejt nga qytetarët. Ankesat në masë të madhe lidhen me refuzime të dëmshpërblimeve nga ana e shoqërive të sigurimit, apo pakënaqësi për pagesa të dëmeve në masën apo afatin e duhur. 28 prej ankesave të mësipërme janë shqyrtuar dhe zgjidhur brenda një kohe të shkurtër nga shoqëritë e sigurimit, ndërsa për pjesën tjetër shoqëritë u kanë kërkuar klientëve dokumentacion shtesë, ose i kanë cuar çështjet për zgjidhje gjyqësore. Të gjitha rastet ende të pazgjidhura janë në monitorimin e vazhdueshëm nga AMF që vepron për çdo rast në interes të zgjidhjes së drejtë, brenda kuadrit ligjor në fuqi.

Seksioni i mbrojtjes së konsumatorit në faqen web është aktiv në pritje të ankesave dhe sugjerimeve dhe në funksion të verifikimit në mënyrë elektronike të çdo police të sigurimit të detyrueshëm motorrik në çdo kohë.

Informacionet mbi sektorët e mbikëqyrtur dhe operatorët e vecantë kanë qenë periodike dhe në nivele profesionale të larta. Gjatë vitit 2008, AMF ka vënë në dispozicion të publikut shumë publikime informuese dhe edukative, ndërsa operatorët gjejnë informacione të vlefshme në hapësirat e dedikuara për ta.

Të nderuar deputetë,

Krahas bashkëpunimit institucional brenda vendit, me të gjithë aktorët, palët e interesuara dhe publikun, AMF ka forcuar kontaktet dhe komunikimin me analoget ndërkombëtarë në fushën e rregullimit dhe mbikëqyrjes dhe ka përfutur asistencë teknike shumë të vlefshme nga institucionet ndërkombëtare financiare.

Mbikëqyrja ndërkufitare është sot një sfidë e të gjithë rregullatorëve financiarë, ndërsa bashkëpunimi vlerësohet si çelësi për ta realizuar atë me sukses. Kjo është shndërruar së fundmi në një sfidë të mbikëqyrjes edhe në Shqipëri, po të kemi parasysh rritjen e pjesëmarrjes së grupeve të huaja financiare, apo shtrirjen e bizneseve financiare Shqiptare në rajon.

Menjëherë pas investimit të dy grupeve me interesa Austriake në Shqipëri, AMF nisi bashkëpunimin me Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë. Takimet e përbashkëta të zhvilluara në Tiranë dhe Vienë kanë përfshirë nivelet drejtuese të institucioneve dhe ekipet teknike të tyre. Gjatë vitit 2008, Kreu i Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Pensioneve në FMA, njëherazi edhe kreu i Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve, vizitoi Tiranën me një axhendë të detajuar të bashkëpunimit dhe mbikëqyrjes ndërkufitare. Drafti i memorandumit të mirëkuptimit midis dy autoriteteve sipas modelit të IAIS-it është tashmë në shqyrtim nga palët dhe pritet të nënshkruhet së shpejti, ndërsa ai pritet të lehtësojë më tej shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin dypalësh të dy autoriteteve.

Viti 2008 shënoi rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit të AMF-së me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe kulmoi në Nëntor me nënshkrimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis dy autoriteteve për mbikëqyrjen ndërkufitare në sektorin financiar jobankar, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave të ndërsjellta. Prioriteti i të dy rregullatorëve mbetet përafrimi i kuadrit ligjor dhe procedurave e metodologjive të mbikëqyrjes në të dy vendet, ndërsa trainimet e përbashkëta janë tashmë një realitet. Në Kosovë aktualisht operojnë me sukses 3 shoqëri Shqiptare të sigurimit të jo jetës.

Proceset e rregullimit dhe mbikëqyrjes kanë vazhduar t'u referohen parimeve, standardeve dhe udhëzimeve të hartuara dhe pranuar nga shoqatat ndërkombëtare të rregullatorëve financiarë. Aktualisht, AMF është anëtare e 3 shoqatave ndërkombëtare të rregullatorëve të sigurimeve (IAIS), letrave me vlerë (IOSCO) dhe pensioneve (IOPS), ndërsa është anëtare aktive me kontribut real në nënkomitetin e Bazës së të Dhënave të Ligjeve të IAIS-it. Kjo strukturë ka një mision shumë të rëndësishëm që lidhet me shkëmbimin e përvojave ligjore të vendeve të ndryshme, dhe zbatimin e praktikave më të mira nga vendet anëtare, ose vëzhguese të IAIS-it. Në publikimet zyrtare të IAIS-it dhe IOPS-it pasqyrohen të përditësuara arritjet e AMF-së në fushën e rregullimit dhe mbikëqyrjes së tregjeve të sigurimeve dhe pensioneve. Gjatë vitit 2008 është bërë një punë intensive dhe është kryer aplikimi për pjesëmarrje në Marrëveshjen Multilaterale të Mirëkuptimit të IOSCO-s.

Edhe në aspektin e asistencës teknike, bashkëpunimi i AMF-së me institucionet financiare ndërkombëtare ka qenë shumë i frytshëm në vitin 2008.

AMF në bashkëpunim me Bankën Botërore nisi një projekt të rëndësishëm që synon përmirësimin e kuadrit ligjor dhe kalimin gradual drejt mbikëqyrjes me bazë riskun në sigurime. Projekti i financuar nga First Initiative, është në proces dhe synon forcimin e regjimit të rregullimit dhe mbikëqyrjes së tregjeve financiare jobankare.

Gjatë vitit 2008 filloi projekti i implementimit të Sistemit të Manaxhimit të Informacionit të AMF-së, i mbështetur nga BERZH-i dhe i financuar nga Fondi i Ballkanit Perëndimor. Me përfundimin e projektit gjatë këtij viti, synohet ngritja e nje platforme teknologjie-informacioni per raportimin, procesimin e prodjimin e raporteve te paralajmerimit te rrezeqeve, per sektorin e sigurimeve fillimisht. Te dy projektet jane komplementare me njeri tjetrin dhe te koordinuar ne implementim.

Të nderuar deputetë,

Pas përshkrimit të punës 1 vjecare të institucionit, më lejoni që në mënyrë të përmbledhur të paraqes përpara jush edhe disa çështje që kanë të bëjnë **me, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe çështje të tjera organizative te AMF-së.**

Gjatë vitit 2008, AMF vazhdoi të funksionojë sipas strukturës së miratuar, nëpërmjet së cilës sigurohet ndarja e qartë e funksioneve dhe rolit të njërive përbërëse. Organika e AMF-së përbëhet nga 45 punonjës, bazuar në ligjin për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008, megjithëse Kuvendi ka miratuar një strukturë me 58 punonjës. Njësia e auditit të brendshëm, luan një rol të rëndësishëm në evidentimin e risqeve me qëllim garantimin e përputhshmërinë ligjore. Ne vlerësojmë që planifikimi i drejtë, i kombinuar me një staf të kualifikuar, dhe bashkëpunimi në rritje me tregjet, mbeten mjete të fuqishme në funksion të realizimit të prioriteteve dhe objektivave të AMFsë.

Në vitin 2008, Bordi i AMF-së ka zhvilluar 12 mbledhje të rregullta, në të cilat janë marrë rreth 180 vendime, një pjesë të të cilave i përmenda më sipër gjatë përshkrimit të punës së AMF-së. Vendimet rregullative kanë të bëjnë me propozime apo miratime të akteve ligjore dhe nënligjore për të tre sektorët, ndërsa vendimet e lidhura me funksionin mbikëqyrës kanë përfshirë masa korrektive dhe sanksione që kanë synuar eliminimin e shkeljeve dhe përmirësimin e veprimtarisë së operatorëve. Vendime me rëndësi kanë qenë dhe ato për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe vlerësuesve të dëmeve, ndërsa vendimet e tjera i përkasin anës institucionale dhe funksionimit të institucionit dhe iniciativave promovuese për tregjet e mbikëqyrura.

Të nderuar deputetë,

Ruajtja dhe rritja e kapaciteteve institucionale mbetet një nga sfidat kryesore të AMF-së në ushtrimin me efektivitet të funksioneve të saj. Në këtë kuadër, duhet të përmend se disa kufizime që lidhen me numrin e punonjësve, strukturën dhe sistemin a pagave ndikojnë drejtpërdrejt në kapacitetet, efektivitetin dhe rritjen e ekspertizës së AMF-së. Për më tepër që tashmë AMF ka arritur pothuajse pavarësi të plotë financiare, në kushtet kur kontributi i buxhetit të shtetit në institucion është vetëm 2 milionë të lidhura me investimet. Kufizimet ulin

mundësinë e absorbimit të eksperteve aq te paket ne kete profil. Unë shpresoj që kjo çështje thelbësore për funksionimin e AMF-së të gjejë vëmendjen dhe trajtimin tuaj brenda një kohe të shkurtër.

Trajtimin dhe motivimin e profesionit të aktuarit është adresuar prej AMF-së gjatë vitit të kaluar në instanca të ndryshme dhe ende pret një zgjidhje pozitive. Konkretisht, ne kemi kërkuar që ky profesion i ri, por shumë i rëndësishëm dhe i vecantë në sektorin e sigurimeve të përfshihet në trajtimin e vecantë që kanë grup profesioneve të ndryshme.

Një çështje tjetër që ndaj sot me ju është ushtrimi i veprimtarisë së institucionit në ambiente të papërshtatshme. AMF nuk ka marrë ende në dispozicion për të rikonstruktuar godinën që i është alokuar që në vitin 2007. Funksionet e mbikëqyrjes janë shumë të rëndësishme dhe kërkojnë hapësira të mjaftueshme e të sigurt për infrastrukturen që i mbështet, ndërsa problemi bëhet edhe më imediat në kushtet e vendosjes në ambientet e AMF-së të platformave informatike të qendrës së informacionit dhe të raportimit elektronik të operatorëve.

Ndërkohë, nga ana e saj AMF është përpjekur brenda mundësive të saj të motivojë punën e stafit dhe ekspertëve dhe të zbatojë politika nxitëse të shkëmbimit të eksperiencës, trainimeve dhe kualifikimeve në përshtatje me pozicionet dhe profilet e punës.

Të nderuar deputetë,

Viti aktual ka vijuar me realizimin dhe përmbushjen e prioriteteve, objektivave dhe detyrave të nisura në vitin 2008, duke shtruar njëkohësisht sfida të reja përpara institucionit tonë.

Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor dhe rritja e efektivitetit të mbikëqyrjes së tregjeve financiare jobankare janë procese të pandërprera. Më poshtë dëshiroj të nënvizoj disa nga objektivat tona konkrete për këtë vit sipas funksioneve dhe drejtimeve kryesore.

- AMF do të vazhdojë bashkëpunimin me Bankën Botërore në rishikimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor të sigurimeve, duke synuar përafrimin me standardet ndërkombëtare dhe direktivat Europiane.
- Është në proces puna për hartimin e të gjitha akteve nënligjore mbështetje të ligjit të ri të transportit, ndërsa pritet të nisë hartimi i akteve nënligjore në mbështetje të tre projekt ligjeve të tjera të hartuara nga AMF, menjëherë pas miratimit të tyre.
- Ka nisur puna për hartimi e akteve nënligjore dhe rregulloreve që nxitin rolin e profesionistëve në sektorin financiar jobankar

- Hartimi i paketës së plotë të manualeve të mbikëqyrjes në vend dhe analizës për sektorin e sigurimeve do të përfshijë elementë të mbikëqyrjes me bazë rrezikun dhe sisteme të paralajmërimeve të hershme. Puna për hartimin e manualeve ka nisur dhe po mbështetet nga Banka Botërore
- Zbatimi për herë të parë i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar përbën një sfidë për shoqëritë e siguresit dhe AMF-në në vitin 2009, ndërsa bashkëpunimi në këtë drejtim ka qenë i vazhdueshëm
- Implementimi dhe vënia në funksionim e platformës elektronike të raportimit është një projekt tjetër në proces në bashkëpunim me BERZH-in, që pritet të përfundojë më sukses brenda vitit 2009.
- AMF do të nxitë më tej bashkëpunimin me tregjet e mbikëqyrura, ndërsa do të rritë nivelin e transparencës e komunikimit me publikun dhe mbrojtjen e konsumatorit.
- Nisur edhe nga situata ndërkombëtare e tregjeve financiare, forcimi i bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave përbën një prioritet të vecantë në garantimin e stabilitetit financiar në vend.
- Bashkëpunimit në rritje me rregullatorët në Austri dhe Kosovë, pritet t’i shtohen kontaktet dhe bashkëpunimi me rregullatorë të tjerë në rajon. Prioritet për vitin 2009 përbën bashkëpunimi me rregullatorët në Maqedoni dhe Greqi, nisur nga sfidat e mbikëqyrjes ndërkufitare.
- AMF do të forcojë bashkëpunimin me të tre shoqatat ndërkombëtare të rregullatorëve, në funksion të implementimit të standardeve të pranuar prej tyre dhe do të rrisë pjesëmarrjen aktive dhe kontributin në këto shoqata.
- AMF do të synojë rritjen e vazhdueshme të kapaciteteve institucionale edhe rritjen e nivelit të ekspertizës, që në një farë mase realizohet gjatë proceseve dhe projekteve ambicioze të ndërmara në bashkëpunim të ngushtë me partnerë seriozë. Politika e motivimit të stafit, nxitjes së profesionistëve, aktivitetet dhe trainimet janë pjesë e strategjisë së AMF-së. Pa dyshim, një vështrim pozitiv i çështjes së ambienteve, apo strukturës së pagave do të kishte ndikim të ndjeshëm në efektivitetin dhe sigurinë e institucionit.

Të nderuar deputetë, për të mbyllur këtë përmbledhje, dëshiroj të theksoj se:

Qëndrueshmëria makroekonomike e Shqipërisë, progresi në regjimin rregullator dhe mbikëqyrës të sistemit financiar jo-bankar, potencialet e larta që ofron vendi dhe masat e marra në drejtim të parandalimit të efekteve të krizës financiare botërore, do të shoqërohen me një rritje të mëtejshme të tregjeve financiare jo-bankare në Shqipëri. Kjo klimë paraqitet shumë e favorshme për rritjen e investimeve të huaja në sektorin financiar jobankar dhe AMF është dëshmitare e pranisë së gjithnjë e më shumë investitorëve prestigjiozë të interesuar për të investuar së shpejti.

Me kënaqësi konstatoj se në dy mujorin e parë të vitit 2009, tregu i sigurimeve është rritur me rreth 32% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Në të njëjtën linjë me forcimin e integritetit të sektorit financiar jobankar, së bashku me tregjet AMF do të nxitë fushata edukuese dhe promovuese për rëndësinë e produkteve financiare dhe rritjen e vetëdijes qytetare, interesit dhe kërkesës për këto produkte.